Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{mink1} \times P_{maxk1} / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink1} Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

P_{maxk1} Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

22. Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

Opsioni 2) – Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, Bazuar në Çmim:

Kontrata do t'i jepet ofertuesit i cili ka ofruar çmimin më të ulët të ofertës.

SHENIM: Autoriteti/Enti Kontraktor do të zgjedhë vetëm një nga Opsionet si kriter i vlerësimit. Përdorimi i të dy opsioneve në DT e bën procedurën të pavlefshme.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor do t'i japë kontratën Operatorit Ekonomik, Oferta e të cilit ka rezultuar të jetë ekonomikisht më e favorshme.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor përdor si kriter vlerësimi një nga kriteret e përcaktuara në Njoftimin e Kontratës.

1. Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti/enti i korigjon këto gabimesi më poshtë:

(a) Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.

(b) Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korigjohet bazuar në të.

(c) Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përfundimisht nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korigjohet.

(d) Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korigjimeve është më pak se 2%, por korigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të

çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.

- Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlogaritur.

- Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

MO = O1 + O2 + O3 + ... On / N

PR = 85 % Mo

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit i 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës i 1. Pas confirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e

mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura ankesës

- e 1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi procedurës

- i 1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca2. Listat e Çmimeve të artikujve

Shtojca3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca6. Formulari i Sasisë dhe Grafikut i lëvrimit

Shtojca7. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 9 : Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 10 Formulari i Njoftimit të Fituesit

Shtojca 11- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 12 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomikshënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt: **[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë**
(në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]
Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]
Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]
Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,
Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Blerje Kite dhe Reagentë për nevoja spitalore”

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Per paisjet qe do te jene ne perdorim

Analizator Imunologjik

Te ofrohet ne perdorim aparat per realizimin e analizave imunologjike me karakteristikat si me poshte:

- Sistem imuno-analizues i automatizuar i cili bazohet në parimin ELFA ose CMIA.
- Rezultati te perftohet minimalisht ne 17 min dhe maksimalisht ne 120 minuta (ne varesi te parametrave te testuar).
- Analizim i njekohshem i parametrave te ndryshem.
- Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT.
- Monitori, tastiera dhe printeri te integruar ne aparat.
- Identifikimi i mostrave: nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem.
- Reagente te inkorporuar ne nje strip te vetem.
- Te kete kapacitet maksimal jo me te vogel se 10 teste.
- Operatori ekonomik te ofroje mundesine e nje aparati back up ne rast kerkese nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.

Analizator Hematologjik

Platforma në përdorim duhet të përbëhet nga dy pajisje automatike të cilat duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Rezultate per 26 parametra te raportueshme duke përfshirë P-LCC, P-LCR
- Te perdore teknikat:Floë Citometri (laser me 3 kende) per numerimin dhe diferencimin e ËBC, metoden e impedancës elektrike për numërimin e RBC dhe trombociteve
- Vëllimi maksimal i mostrës 15 µl
- Kapaciteti maksimal jo me pak se 60 mostra/orë
- Te ofroje 3 mënyra numërimi - Gjak komplet, Kapilar dhe hollim paraprak
- Te kete kapacitet te ruajtjes jo me pak se 40000 rezultate (me grafiket perkates)

-
- Te mundesje matjen e hemoglobines perms metodes se kolorimetrise (reagent pa cyanide).
 - Identifikimi i mostrave te realizohet nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem
 - Printer per printimin e pergjigjeve te analizave
 - Operatori Ekonomik merr persiper te kontribuojne ne lidhjen e pajisjeve te ofruara ne sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar

Analizator Elektrolitik

Te ofrohet ne perdorim aparat portable I bazuar ne perdorimin e katrixheve per te analizuar gazet ne gjak, elektrolitet, markerat kardiake, faktoret e koagolimit.

Karakteristikat e Aparatit:

- Rezultati i analizes te perftohet ne intervalin kohor minimal jo me shume se 2 min dhe maksimal jo me shume se 20 min (ne varesi te testit te realizuar).
- Mostra e perdorur: 2-3 pika gjak i plote ose plasmë
- Te perdore metoden e matjes direkte elektrokimike.

Analizator Koagolimi

Platforma ne perdorim duhet te perbehet nga dy pajisje (kryesore dhe back-up) te cilat duhet te plotesojne kriteret e meposhtme:

Aparati kryesor plotesisht i automatizuar:

- Metodologjia: Sistemi I detektimit I bazuar ne viskozitet.
- Kapaciteti rreth 100 mostra.
- Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT.
- Te realizoje hollimin automatik te mostrave
- Paisja duhet te realizoje back up automatik.
- Paisja duhet te identifikojne mostrat positive.

Aparati back up gjysmeautomatik:

- Metodologjia: Sistemi I detektimit I bazuar ne viskozitet
- Te jete i paisur me te pakten 4 kohemates te inkorporuar ne aparat me alarm zanor.
- Operatori Ekonomik merr persiper te kontribuojne ne lidhjen e pajisjeve te ofruara ne sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar

Paisje Biokimike

Te ofrohet ne perdorim aparat biokimik plotesisht i automatizuar qe nga procesi i kalibrimit, kontrollit dhe testimit me karakteristikat e meposhtme:

- Metodologjia: Integrim i 4 parimeve matese: Fotometri absorbance, Turbidimetri, Polarimetri fluoeshente, Potenciometri (jon selective)
- Kapaciteti rreth 400 teste/ ore
- Tipologjia e mostres se perdorur: serum, plasme, urine, CSF, hemolizat dhe gjak komplet (HbA1c)
- Aparati duhet te realizoje hollim automatik te mostrave
- Identifikimi I mostrave duhet te realizohet nepermjet lexuesit automatik te barkodeve
- Te ofroje mundesine e analizimit prioritar te mostrave STAT.
- Të punojnë me ngarkesë të vazhdueshme
- Operatori ekonomik duhet te ofroje aparatin per distilimin e ujit nese nevojitet per zbatimin e protokollit te testeve biokimike.
- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar

Analizator Urine

Te ofrohet ne perdorim aparat gjysmeautomatik per analizimin e stripeve te urines me karakteristikat e meposhtme:

- Metodologjia: Fotometri reflektance.
- Kapaciteti rreth 600 stripe urine/ore
- Te kete kapacitet te ruajtjes deri ne 1000 rezultate te mostrave dhe jo me shume se 300 rezultate te kontrolleve
- Printeri: Termal printer
- Parametrat e analizuar: pesha specifike, ph, leukocitet, nitrite, proteina, glukoza, ketonet, urobilinogen, bilirubine, eitrocite, hemoglobine, ngjyra.
- Te ofrohet mundesia e kalibrimit te testeve.
- Identifikimi i mostrave: manualisht ose nepermjet nje lexuesi barkodi te jashtem.
- Operatori Ekonomik merr përsipër te kontribuojë ne lidhjen e pajisjeve të ofruara në sistemin LIS dhe ofron mirembajtjen e pajisjeve deri ne mbarimin e plote te artikujve te prokuruar.

Operatori Ekonomik merr përsipër të ofrojë në përdorim pajisjet ndihmëse për mbarevajtjen optimale të procesit të punës si më poshtë vijon:

Centrifuge (2 cope)

Te jepet në përdorim 2 centrifuga për tubat e gjakut dhe urines me karakteristikat si më poshtë:

Centrifuge me rotor të lirë dhe kapacitet 30- 40x13mm për tubat e gjakut dhe centrifuge me rotor të fiksuar dhe kapacitet 20x15ml për tubat e urines.

Mikroskop (1 cope)

Te jepet në përdorim 1 mikroskop për ekzaminimin e gjakut dhe urines:

Mikroskop binokular me BE2 plan achromat.

Ndricimi: LED

Zmadhimi maksimal: 100x

Pajisjet ndihmëse si më poshtë vijon:

Perzieres për tubat e gjakut (1 cope)

Homogjenizues tubash (1 cope)

Barcode Printer (1 cope)

Pipeta (4 cope)

***Koha e dorëzimit, instalimit dhe vendosjes në punë të aparateve do të jetë 7 dite nga momenti i lidhjes së kontratës.**

Shtojca 6

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

“Blerje Kite dhe Reagentë për nevoja spitalore”

Nr	Lloji Ekzaminimit	Emertimi	Njesia	Nr testeve te parashikuara	Nr kiteve qe duhen
1	Hemogram 5P-L	Solucion per numerimin e RBC dhe trombociteve per aparatn Hematologjik ose ekuivalent	cope	10500	13
		Solucion per numerimin dhe diferencimin e ËBC per aparatn Hematologjik ose ekuivalent	cope		18
2	Creatinine	Kit per matjen sasiore te Kreatinines (Metoda Jaffe) ne serum dhe plasem x 700 TESTE ose ekuivalent	kit	10000	16
3	Urea	Kit per matjen sasiore te Urese ne serum plasem dhe urine x 500 TESTE ose ekuivalent	kit	9500	20
4	Gluc	Kit per matjen sasiore te Glukozes ne serum, plasem, urine dhe CSF , x 800 TESTE ose ekuivalent	kit	8000	11
5	ALT-SGPT	Kit per matjen sasiore te Alanine Aminotranferases ne serum dhe plasem x 500 TESTE ose ekuivalent	kit	8000	17
6	AST-SGOT	Kit per matjen sasiore te Aspartat Aminotransferases ne serum dhe plasem x 500 TESTE ose ekuivalent	kit	8000	17
7	Bilirubine total	Kit per matjen sasiore te Bilirubines Totale ne serum dhe plasem tek neonatet dhe adultet x 250 TESTE ose ekuivalent	kit	6000	24
8	Elektrolit (Na+K+Cl)	Elektrode per matje e Cl- ose ekuivalent	cope	5900	12
		Elektrode per matjen e Potasiumit (K+) ose ekuivalent	cope		12
		Elektrode per matjen e Sodiumit (Na+) ose ekuivalent	cope		12
9	CRP Imuno	Kit per matjen e proteine c reaktive x250 teste ose ekuivalent	kit	4500	19
10	U-Komp	Stripe urine te cilat analizohen (lexohen) ne aparat x 100 teste ose ekuivalent	kuti	4000	40
11	Lipid Tot	Kit per matjen sasiore te Kolesterolit x400 TESTE ose ekuivalent	kit	8000	20

		Kit per matjen sasiote te HDL x 350 TESTE ose ekuivalent	kit		23
		Kit per matjen sasiore te LDL x 200 TESTE ose ekuivalent	kit		40
		Kit per matjen sasiore te Triglicerideve x250 TESTE ose ekuivalent	kit		32
12	A Urik	Kit per matjen sasiore te Acidit Urik x 400 teste ose ekuivalent	kit	3800	11
13	Bilirubine direct	Kit per matjen sasiore te Bilirubines Direkte ne serum dhe plasem x 350 TESTE ose ekuivalent	kit	3000	10
14	Calcium	Kit per matjen sasiore te Kalciumit ne serum, plasem dhe urine x 300 TESTE ose ekuivalent	kit	2500	10
15	Albumin, serum	Kit per matjen sasiore te Albumines ne serum dhe plasem x 300 TESTE ose ekuivalent	kit	2500	10
16	TSH	Kit per matjen sasiore te TSH nepermjet metodes ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	2500	42
17	Protein, Total	Kit per matjen sasiore te Proteinave Total x 300 TESTE ose ekuivalent	kit	2500	9
18	HbA1c	Kit per matjen sasiore te HbA1c X 150 TESTE ose ekuivalent	kit	2000	14
19	D-dimer, quantitative	Kit per matjen sasiore te D Dimerit nepermjet metodes ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	1500	25
20	CK	Kit per matjen sasiore te Kreatinine Kinases ne serum dhe plasem x 200 TESTE ose ekuivalent	kit	1800	9
21	ALKP	Kit per matjen sasiore te Alkaline Fosfatasas ne serum dhe plasem x 400 TESTE ose ekuivalent	kit	1800	5
22	GGT	Kit per matjen sasiore te Gamma Glutamyl Transferase 2 (GGT-2) ne serum x 400 TESTE ose ekuivalent	kit	1800	5
24	aPTT	Reagent per matjen e aPTT me metoden SDV ose ekuivalent	kuti	900	10
		Buffer Oëren Koller (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti		2
		Reagent CaCl ₂ 0.025 M (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti		1
		Reagent per percaktimin e Kohes se Aktivizimit te Tromboplastines (aPTT: 6 x 2 mL) ose ekuivalent	kuti		1
25	RF	Kit per matjen sasiore te Faktorit Reumatologjik ose ekuivalent	kit	1500	15
26	PT & INR	Reagent per matjen e PT/INR me metoden SDV ose ekuivalent	kuti	3500	7
		Reagent CaCl ₂ 0.025 M (24 x 15 mL) ose ekuivalent	kuti		1

		Reagent per matjen e kohes se Protrombines CI+5 (PT: 6 x 5 mL) ose ekuivalent	kuti		5
28	FT4	Kit per matjen sasiore te FT4 nepermjet metodës ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	1800	30
29	FT3	Kit per matjen sasiore te FT3 nepermjet metodës ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	1800	30
30	LDH	Kit per matjen sasiore te LDH x 300 Teste ose ekuivalent	kit	1500	5
31	Troponin I, quantitative Imuno	Kit per matjen sasiore te Troponin I nepermjet metodës ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	3000	50
32	Ferritin	Kit per matjen sasiore te Ferritines nepermjet metodës ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	1300	22
33	Fibrinogen Activity	Reagent likuid per matjen sasiore te Fibrinigenit me metoden Clauss (12 x 4 mL) ose ekuivalent	kuti	1200	10
34	CKMB-B	Kit per matjen sasiore te CKMB x 100 TESTE ose ekuivalent	kit	1200	12
35	Fe	Kit per matjen sasiore te Hekurit x 200 TESTE ose ekuivalent	kit	1000	5
36	PSA Tot	Kit per matjen sasiore te PSA totale nepermjet metodës ELFA X 60 teste ose ekuivalent	kit	800	14
37	Phosphorus	Kit per matjen sasiore te Fosforit x 250 TESTE ose ekuivalent	kit	700	3
38	Anti TPO	Kit per matjen sasiore te TPO neperjet metodës ELFA x 30 teste ose ekuivalent	kit	600	20
39	Magnesium	Kit per matjen sasiore te Magnesiumit x 250 TESTE ose ekuivalent	kit	600	3
41	Triglycerids	Kit per matjen sasiore te Triglicerideve x250 TESTE ose ekuivalent	kit	400	2
42	Amylase, Total	Kit per matjen sasiore te Amilases ne serum plasem dhe urine x 300 TESTE ose ekuivalent	kit	300	1
43	Cholesterol	Kit per matjen sasiore te Kolesterolit x400 TESTE ose ekuivalent	kit	300	1
44	CEA	Kit per matjen sasiore te CEA nepermjet metodës ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	300	5
45	HDL	Kit per matjen sasiore te HDL x 350 TESTE ose ekuivalent	kit	250	1
46	LDL	Kit per matjen sasiore te LDL x 200 TESTE ose ekuivalent	kit	250	2
47	Gaze Gjak + Elektrolite	Katrixh per matjen e gazeve elektroliteve dhe Kalciumit te jonizuar ne gjak x 25 teste ose ekuivalent	kit	400	16

48	Lipase	Kit per matjen sasiore te Lipases nepermjet metodes kolorimetrike x 200 TESTE ose ekuivalent	kit	100	1
49	CKMB	Kit per matjen sasiore te CKMB nepermjet metodes ELFA x 30 teste ose ekuivalent	kit	100	4
50	CA 19-9	Kit per matjen sasiore te CA 19-9 nepermjet metodes ELFA x 30 teste ose ekuivalent	kit	150	5
51	Free PSA	Kit per matjen sasiore te FPSA nepermjet metodes ELFA x 30 teste ose ekuivalent	kit	150	5
52	N-proBNP / BNP	Kit per matjen sasiore te PROBNP nepermjet metodes ELFA x 60 teste ose ekuivalent	kit	150	3
53	C4	kit per matjen sasiore te komplementit C4 x 100 teste ose ekuivalent	kit	80	1
54	C3	kit per matjen sasiore te komplementit C3 x 100 teste ose ekuivalent	kit	80	1
55	Cholinesterase	Kite per matjen sasiore te Cholinestrases X 200 Teste ose ekuivalent	kit	30	1
		Vlera pa TVSH			
		TVSH			
		Vlera me TVSH			

AFATET E LËVRIMIT:

Afatet e lëvrimit: afati maksimal i lëvrimit për 12 muaj.

Shtojca 7

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
 - b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
 - ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
 - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
 - f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
 - g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
 - gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
 - h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
 - i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

-
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;
- c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;
- ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, me objekt aktiviteti të certifikates për tregtim të materialeve mjekësore ose ekuivalent në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose FDA ose deklaratë konformiteti CE ose FDA (Aty ku është e aplikueshme) sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt e ofruar sipas kategorizimit të tyre (Dokumentat duhet të jenë të perkthyer dhe të noterizuara).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë **3 (tre) viteve** tefundit (**2019, 2020, 2021**), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se **29 000 000 lekë**, (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon vlerën e fondit limit të parashikuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të ulët se **11 000 000 lekë**. (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nuk tejkalon **40% të vlerës së parashikuar të kontratës**).

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese .

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuar).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuar).

d) Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur. (Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuar).

e) Operoret ekonomike duhet të paraqesin një vetedeklarim ku të deklarohej që skadencia e mallrave do të jete sipas kushteve të percaktuara në specifikimet teknike.

Per Paisjet qe ve ne perdorim prane SRMF :

a. Autodeklarate ku saktësohet nr. dhe tipi i analizatoreve përfshirë aksesoret e tij të cilët OE do t'i instalojë duke bashkelidhur materialin përshkrues:

b. Lloji i paisjes, modeli, viti i prodhimit, kompania prodhuese, vendi i prodhimit, gamen e plote të analizave të cilat propozon dhe është në gjendje të bëjë sistemi

Shënim. Apartura dhe aksesoret të jene sipas specifikimeve teknike të DS. Gjithashtu të ofrohet një sistem back up i aparaturës shoqëruar me listen e aksesoreve të cilat duhet të jene në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes, të reagenteve dhe afatit të levrimit të pasqyruara në DS.

c. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për ofrimin e paisjeve të kërkuara në funksion të përdorimit të testeve nga AK sipas specifikimeve teknike të DT . (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuar).

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës. (Dokumentat duhet të jene te perkthyer dhe te noterizuar).

d. Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. (paisjeve) Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur.

(Katalogët duhet të ngarkohen në ëëë.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT . (Dokumentat duhet te jene te perkthyer dhe te noterizuar).

e. Vetedeklarim qe bashke me sasine e reagenteve do te siguroje edhe paisjet sipas kerkesave te DST.

f.Deklarate per trajnimin e personelit qe do te perdore aparaturat dhe do te kryeje analizat .

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I.Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT -i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori**

ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: <hr/> <hr/> etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]

<p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
